

**Data 06.02.2023**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit: “Rikonstruksioni i rrugës “At Stath Melani”**

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi.**

**Vlera e fondit limit: 90,049,078.35** (nëntëdhjetë milion e dyzet e nëntë mijë e shtatëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**
- b. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit ,Shtojce 2**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 te DST).

- c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**
- d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

**d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të**

*vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

#### **Sipas Shtojcës 7 të DST**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

*Shëmin:* Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2. Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: **90,049,078.35** (nëntëdhjetë milion e dyzet e nëntë mijë e shtatëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e pesë). *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 dhe për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

#### **Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

#### **1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përllëgëritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **45,024,539.17** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **180,098,156.7** lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpervendura e ben oferten të kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

## **1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
    - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
    - Kontratë Sipërmarrje;
    - Situacionin përfundimtar;
    - Aktin e kolaudimit;
    - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
  - b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
    - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
    - Kontrate Sipërmarrje;
    - Situacionin përfundimtar;
    - Aktin e kolaudimit;
    - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
    - Fatura tatimore përkatëse.
- 1.3** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4** Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

**Argumentimi:** Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **45,024,539.17** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **180,098,156.7** lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikava (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti*

*kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në menyre sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuader të vlerësimit të ofertave në menyre sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në menyre direkte dhe as në menyre indirekte. Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jene të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: **”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”** .

### **1. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P. 1 - A Punime gjurmimi në tokë;
- N.P. 4 – C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale;
- N.P. 7 – B Ujësjetllësa, gazsjellësa, vajsjetllës, vepra kullimi e vaditje;
- N.P. 11 - A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- N.S. 1 – A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S. 6 – A Sinjalistika rrugore jo ndricuese
- N.P. 12 – A Punime të inxhinierisë mjedisore
- N.S. 18 - A Punime topogjeodezike.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategorite e licenses “N.P dhe N.S” të përcaktuara në pikën 2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik janë hartuar në përputhje me zërat konkret të punës që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për këto kategori si dhe të disponojë nënkategoritë sipas gjurmave që parashikohen nga legjisllacioni përkatës. Përcaktimi i nënkategorive është vendosur nga mbledhja e vlerave të secilit volum pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
  - a) Librezë pune;
  - b) Kontratë pune e vlefshme;
  - c) Diplomë.

*(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i*

*pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas pergjindjes se bashkepunimit).*

**Argumentimi:** *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektroteknik, mjedisi, hidroteknik, topograf, gjeolog, arkitekt është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP4, NP2, NP5, NS1, NS4, NS9** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP1, NP2, NP8,** eshte e nevojshme prezenca e **një Inxhinier Hidroteknik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP 11, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Elektrik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 18** eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet/Topograf/**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.



- Referuar kategorisë së kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës N.P. 12 – A Punime të inxhinierisë mjedisore është e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Mjedisi**.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi 40 (dyzet) punonjës të vertetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 40 (dyzet) punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimin të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 12 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

5. Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për *specialistin Ekspert Zjarrfikës* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin".

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimit etj të cilat kanë potencial të shpëtimin të aksidentëve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e **1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.**

6. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:
- a) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")*.
  - b) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 2 (dy) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë")*.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për 1 (një) *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit te cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojne çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkakimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) punonjesi te pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome leshuar nga autoritetet pergjegjese shtetore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 2 punonjes teknik ndertimi
- 2 punonjes elektrikist
- 2 punonjes hidraulik
- 4 manovrator

- Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratë individuale të punës te vlefshme;
- Diplomë që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- Çertifikate e sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT), e cila duhet te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument.

- Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;
- leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. Në rastin kur punonjësit manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

-Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit manovratorë, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, si dhe numrin e deshmise së aftësisë profesionale.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet

teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik.

Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash : të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist**;
- b) buldozer gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke : të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj., manovratorëve u jepet dëshmi për **Buldozerist**.
- c) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**.

8. Operatori ekonomik duhet paraqesë një CV të shoqërisë ku të pasqyrohen të gjitha punët e realizuara gjatë aktivitetit të tij dhe listë të personelit, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Lista e personelit të kërkuar duhet të përfshijë dhe CV-të e tyre.

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për *specialistin Ekspert Zjarrfikës* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet e kerkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skadat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike.

*Operatori ekonomik duhet te specifikojë ne forme tabele: emrin e kompanisë prodhuese, emërtimin e katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, emërtimin e artikullit (kodi) nxjerrë nga manuali i prodhuesit, linku i produktit në ëeb-in e prodhuesit si dhe çertifikimet përkatëse për secilin produkt.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kerkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kerkuara në Specifikimet teknike .

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gëjkojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kerkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me qëllim që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kerkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilësie etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilësie , certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës në pikën 2.17

garanton Autoritetin Kontraktor per cilesine dhe standartet e larta nderkombetare dhe te perditesuara sipas teknologjise se re dhe bashkekohore.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **12 (dymbëdhjetë) muaj** kalendarike.
11. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
  - PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi i mirëfilltë.
  - PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

**Argumentimi:** Këto kërkesa janë vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 dhe kane te bejne me garikun e punimeve; fazat si dhe afatet e realizimit te punimeve.

12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:
  - a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
  - b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
  - c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
  - d) Çertifikatën e menaxhimit te energjise ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2011 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2011 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2011. Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të



këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 14 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

13. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Auto veteshkarkues me kapacitet minimal jo me pak se 10 ton dhe maksimal jo me shume se 20 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Rul me vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Sharre për prerje asfalti	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Makineri skarifikim shtresa	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Rul me kompresor	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Autobitumatriçe	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Fadrome me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Elektrosaldatriçe	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Gazogjen	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Autovinç	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Vinç ekskavator	copë	1	Në pronësi ose me qera

15	Betonjere 500 liter	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Vibrator thellesie	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Vibrator	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Sonde "UKS"	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Vinç kulle 0.5 ~ 1 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
	Autovinc me kosh		1	Në pronësi ose me qera
	Ngjeshes (tokmak) elektrik ose pneumatik		1	Në pronësi ose me qera
	Sperkates boje		1	Në pronësi ose me qera

**a)** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

**b)** Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

**c)** Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

**d)** Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

**e)** Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

**13.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

**13.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane.

**13.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislationit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve përkatës se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetohet se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e*

*mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*